



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SARANDË

Nr.6 Prot .

Sarandë, më 11.01.2018

**RREGULLORE
PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT TË PUNËMARRËSVE NGA
PËRDORIMI I PRODUKTEVE TË DUHANIT NE GJYKATËN E RRETHIT
GJYQËSOR SARANDË**

Hyrje

Bazuar në ligjin Nr.9636, datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”,^(i ndryshuar) nenet 3,15, ligjin nr. Nr.8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Proedurave Administrative të RSH” ligjin Nr.10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, ligjin Nr. 4/2014 të miratuar me datë 30.01.2014 “Për ratifikimin e konventës C187 të organizatës ndërkombëtare të punës (ILO) “Për kuadrin promociional të sigurisë dhe të shëndetit në punë - 2006” si dhe ne ligjin Nr. 9474, datë 09.02.2006 “Për ratifikimin e konventës kuadër të organizatës botërore të shëndetësisë - Për kontrollin e duhanit”, për të garantuar sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve dhe të personave të tjerë në mjediset e institucionit, duke patur parasysh pasojat e dëmshme që sjell duhani për shëndetin e njeriut, miratohet kjo rregullore e cila ka për qëllim ndalimin e pirjes së duhanit brenda mjediseve të brendshme.

**Neni 1
Përkufizime**

“Mjedis pune” konsiderohet çdo hapësirë e mbyllur, ku punonjësit ushtrojnë veprimtarinë dhe detyrat për të cilat janë punësuar, si dhe salla mbledhjesh, korridore, shkallë, dhe çdo mjedis tjetër i mbyllur, që frekuentohet gjatë orarit të punës.

“Pirje duhani” është ndezja, thithja dhe mbajtja në dorë e ndezur e çdo produkti duhani që digjet.

“Tavllë duhani/ taketuke cigareshe” është një enë e vogël ku shkundet hiri i produktit të duhanit që po digjet dhe ku lihen bishtat e cigareve.

“Masat parandaluese të duhanpirjes” janë veprimtaritë sistematike, që synojnë të sigurojnë mbrojtjen e shëndetit të popullsisë, duke zgjatur jetën dhe përmirësuar cilësinë e saj.

Neni 2

Përgjegjësia e Punëdhënësit

Punëdhënësi detyrohet të marrë masa dhe të miratojë rregulla për sigurimin dhe mbrojtjen e punëmarrësve në të gjitha aspektet që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë nga përdorimi nga produktet e duhanit.

- a. Punëdhënësi në marrjen e masave për mbrojtjen e sigurisë e të shëndetit në punë, udhëhiqet nga parimi i trajtimit të barabartë.
- b. Detyrimet e punëdhënësit për marrjen e masave të veçanta në punë të punëmarrësve, janë të domosdoshme për garantimin e sigurisë dhe shëndetit të tyre.

Neni 3

Tabela " NDALOHET PIRJA E DUHANIT "

Personat përgjegjes marrin masa që në mjedis të dukshëm (ambiente pune, salla gjyqi, korridore, etj.) të vendosen tabela të dukshme dhe të lexueshme, " NDALOHET PIRJA E DUHANIT".

Neni 4

Masat per ndalimin e pirjes se duhanit

Pirja e duhanit nënkupton përdorimin e produkteve të duhanit brenda mjediseve publike, duke marrë parasysh që ekspozimi i pavullnetshëm ndaj tymit të çliruar, krijon pasoja të rënda për shëndetin në mënyrë aktive dhe pasive.

Ndalohet pirja e duhanit nëpër të gjitha mjediset e brendshme të institucionit të Gjykatës.

Kancelari është përgjegjese për vendosjen brenda mjediseve të gjykatës të listës së trupave inspektuese për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit.

Gjithashtu ka për detyrë:

- a. Vendosjen e shenjave të dukshme (të miratuara nga KNMSHPD-ja), që tregojnë se pirja e duhanit në këto mjedise është e ndaluar,.
- b. Heqjen e tavllave të duhanit në këto mjedise.
- c. Mbikqyrjen dhe respektimin e rregullave për ndalimin e pirjes së duhanit në mjediset e brendshme të institucionit.
- d. Organizimin e aktiviteteve ndërgjegjëse në ditën botërore kundër duhanit (datë 31 Maj).

Neni 5

E drejta e informimit

Çdo punëmarrës duhet të informohet për pasojat shëndetësore, natyrën droguese dhe kërcënimin vdekjeprurës të shfaqur nga konsumimi i duhanit tij, si dhe për masat e marra për mbrojtjen e të gjithë stafit nga ekspozimi ndaj tymit të duhanit.

Neni 6

Institucionet Përgjegjëse

Institucionet përgjegjëse për kontrollin e zbatimit të këtij ligji, bëjnë verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, në përputhje me ligjin Nr. 10 433, datë 16.06.2011 *“Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”*.

Institucionet përgjegjëse për kontrollin e zbatimit të ligjit Nr.9636, datë 06.11.2006 *“Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”*, janë:

- a. Inspektoriati që mbulon fushën e shëndetit;
- b. Inspektoriati që mbulon fushën e punës;
- c. Inspektoriati i sigurisë ndaj zjarrit;

Neni 7

Shkelja e dispozitave

Shkeljet e dispozitave të percaktuara në ligjin Nr.9636, datë 06.11.2006, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

- a. 300.000 lekë personi i tatueshëm.
- b. 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, personi përgjegjës në institucionet publike;
- c. 5 000 lekë (pesë mijë) lekë, duhanpirësi;

Masa e gjobes parashikohet si dënim më vete dhe jepet nga trupat inspektuese. Ankimi ndaj vendimeve të trupave inspektuese, të percaktuara në ligj, bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.

Pas përfundimit të procedurave të ankimit administrativ, bëhet ankim në Gjykatën Administrative, brenda afateve dhe të parashikuara në dispozitat ligjore.

Neni 8

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I GJYKATËS

Alltun ÇELA

